



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2023:243265  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05556917

C. nr. 746/2023

Gjykata Themelore Gjilan - Degë në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses në çështjen juridike kontestimore të paditësit L. Th. nga ....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fis Murati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit në emër të kualifikimit (licencimit), jashtë seance gjyqësore, më datë 08.04.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

I. Hudhet poshtë padia me numër C.nr.746/2023, e datës 03.11.2023, e paditësit L. Th. nga ....., e paraqitur kundër të paditures Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit në emër të kualifikimit (licencimit), për shkak se çështja është gjë e gjykuar (Res Iudicata).

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 03.11.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditures Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit në emër të kualifikimit (licencimit), me vlerë të kontestit prej 1015.30 euro.

Gjykata, me datë 06.02.2024, ka pranuar përgjigjen në padi nga pala e paditur, me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar me arsyetimin se me Aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.630/23, të dt.08.12.2023, lidhur me këtë qështje juridike kontestimore është vendosur një herë, dhe ka kërkuar nga gjykata që konform nenit 391 pika d), padinë e paditësit

ta hudhë poshtë për shkak se kjo lëndë është qështje e gjykuar, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata ka gjetur së për këtë çështje juridike kontestimore është vendosur njëherë sipas Aktgjykimit C.nr.630/2023, të datës 08.12.2023, dhe se për gjykatën kjo çështje juridike kontestimore ndërmjet palëve të njejta me objekt kontesti të njejtë është lëndë e gjykuar (res iudicata), prandaj gjykata vendosi që ta hedhë poshtë padinë e paditësit

Gjykata, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta konform nenit 452 të LPK-së, ngase pala e paditur nuk i ka kërkuar.

Nga të cekurat më lartë, gjykata, duke u bazuar në nenin 391 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizion Civil  
C. nr. 746/2023, më datë 08.04.2024

Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë.